

Njoftim për përqendrim me të cilin Austroterm GmbH, Austri, do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqëritë Gruppo Poron S.r.l., Itali dhe Italkonsult S.r.l., Itali, përmes blerjes së 100% të aksioneve në Shoqëritë e Synuara (lënda nr. 08-80/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 23.04.2025, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga Austroterm GmbH, Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, mbi shoqëritë Gruppo Poron S.r.l. dhe Italkonsult S.r.l., të dyja me seli në via Vercelli 19, Romë, Itali, përmes blerjes së 100% të aksioneve në Shoqëritë e Synuara.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Austroterm GmbH është kryesisht aktive në prodhimin dhe shitjen e materialeve izoluese të prodhuara nga polistireni i zgjeruar (“EPS”) dhe polistireni i ekstruduar (“XPS”), të cilat përdoren si materiale izoluese për ndërtesa, por me fusha të ndryshme aplikimi. Portofoli i produkteve të Austroterm GmbH plotësohet me profile fasade dhe panele ndërtimi për veshje dysHEMEJE dhe muresh.

Austrotherm është pjesë e Schmid Industrieholding GmbH (*Schmid Industrieholding G.m.b.H.*), Austri (“SHIH”). Përmes shoqërive të lidhura, SHIH është aktive në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë nxjerrjen e lëndëve të para (kryesisht gëlqere, talk); prodhimin e çimentos; materiale për industrinë e ndërtimit (si bojëra, produkte të montuara, veshje, suva, izolim, stuko, mbushës, tulla, çimento, industri betoni); tregti, furra magazinimi, industri reklamuese dhe pajisje për gjueti.

SHIH ka një shoqëri të lidhur të themeluar në Maqedoninë e Veriut, BAUMIT SHPKNJP Shkup, me seli në Jadranska Magistrala 165, Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut, aktive në furnizimin me produkte BAUMIT si suva të thata, sisteme fasade, panele izoluese dhe sistem kompozit për izolim të jashtëm termik.

Gruppo Poron S.r.l. është një shoqëri italiane që merret kryesisht me prodhimin, transformimin dhe shitjen e produkteve nga EPS. Përveç kësaj, Gruppo Poron S.r.l. është aktive edhe në shitjen e produkteve nga XPS, si dhe prodhimin e ambalazheve të polistirenit për sektorët e kopshtarisë, qumështit, peshkut, mjekësisë dhe hotelerisë.

Italkonsult S.r.l. është pjesë e të njëjtës grup si Gruppo Poron S.r.l. dhe është kompani e pasurive të paluajtshme e grupit, e cila merret me lizing të pasurive të paluajtshme industriale. Italconsult S.r.l. zotëron ndërtesa dhe parcela në lokacionet prodhuese dhe i jep me qira Gruppo Poron S.r.l.

Shoqëritë e Synuara nuk kanë shoqëri të lidhura, aktivitete apo të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Pjesëmarrësit në përqendrim theksojnë se si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit të propozuar mund të konsiderohet prodhimi dhe tregtia me shumicë e materialeve izoluese.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

29.04.2025

Shkup